


FLUKSI 2024

Shqipëria ka treguar një performancë solide në tërheqjen e flukseve të IHD-ve përgjatë periudhës së viteve të fundit, duke ruajtur një trend të qëndrueshëm rritës në periudha afatgjata.

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, trendi i investimeve të huaja direkte (IHD) në terma të fluksit, vijon si më poshtë:



Për vitin 2024, indikator i **fluksit** shënon vlerën rreth **€ 1.6 miliardë**, duke shënuar shifër rekord në fluksin e investimeve të huaja direkte në vend. Krahasuar me vitin 2023, treguesi i fluksit ka pësuar **një rritje me € 84 milionë** ose me **5.6%**.

FLUKSI SIPAS SHTETEVE

Për vitin 2024, fluksi i investimeve të huaja në vend është dominuar nga **Turqia** e cila ka kontribuar me rreth **16.2%** në fluksin total, e ndjekur nga **Italia** me **12.6%**, **Hollanda** me **11.1%**, **Austria** me **7.5%** dhe **Kosova** me **6%**.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për 2024 sipas shteteve kryesore:



FLUKSI SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Për vitin 2024, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve në terma të fluksit ishte sektori i **Aktivitetëve të pasurive të paluajtshme** që përfaqësonte rreth **24%** të fluksit total.


Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë janë sektori i **Aktivitetëve financiarë dhe të sigurimit** me **18.1%**, i **Industriës nxjerrëse** me **13.5%**, i **Industriës përpunuese** me **11%** dhe i **Energjisë elektrike, gazit, dhe furnizimit me ujë** me **10.4%** dhe ai ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të fluksit për 2024 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

Aktivitete të pasurive të paluajtshme	379
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	287
Industria nxjerrëse	214
Industria përpunuese	173
Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë	166

STOKU 2024

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, trendi i investimeve të huaja direkte (IHD) në terma të stokut, vijon si më poshtë:



Në fund të vitit 2024, indikator i **stokut** shënon vlerën rreth € **15.4 miliardë**, duke shënuar shifër rekord në stokun e investimeve të huaja direkte në vend. Krahasuar me vitin 2023, treguesi i stokut ka pësuar **një rritje me rreth € 2.2 miliardë ose 16.2 %**.

STOKU SIPAS SHTETEVE

Në fund të vitit 2024, stoku i investimeve të huaja në vend është dominuar nga **Hollanda** e cila ka kontribuar me rreth **16.5%** në stokun total, e ndjekur nga **Zvicra** me **14.7%**, **Kanadaja** me **12.5%**, **Italia** me **11%** dhe **Turqia** me **8.4%**.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut për 2024 sipas shteteve kryesore:



STOKU SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Në fund të vitit 2024, burimi kryesor i hyrjeve të stokut të IHD-ve ishte **Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë** që përfaqësonte **23.7%** të stokut total. Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë në IHD në terma të stokut janë sektori i **Industirisë nxjerrëse** me **16.4%**, Aktiviteteve të **pasurive të paluajtshme** me **13.2%**, i **Aktivitetëve financiarë dhe të sigurimit** me **11.6%**, i **Informacionit dhe Komunikacionit** me **9.8%** dhe i **Industirisë përpunuese** me **9.2%** ndaj totalit.

Më poshtë gjendet tabela me vlerat përkatëse të stokut për vitin 2024 sipas aktiviteteve ekonomike kryesore:

Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	3,659
Industria nxjerrëse	2,534
Aktivitete të pasurive të paluajtshme	2,038
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	1,797
Informacioni dhe komunikacioni	1,516
Industria përpunuese	1,422